



KUVENDI KOMUNAL PRISHTINE * MUNICIPALIT ASSEMBLY PRISHTINA * SKUPSTINA OPSTINA PRISTINA

Në bazë të nenit 40 të Statutit të Komunës së Prishtinës, Kuvendi i Komunës së Prishtinës në mbledhjen e mbajtur më 27.02.2003, mori

V E N D I M
PËR KOMPENSIMIN MATERIAL (FINANCIAR) PËR ANËTARËT E
KUVENDIT, KRYETARËT E KOMITETEVE DHE ANËTARËT E
KOMITETEVE

I

1. Anëtarët e Kuvendit Komunal në Prishtinë

- Kompensimi material (financiar) për anëtarët e Kuvendit të Komunës së Prishtinës do të jetë 50 €(pesëdhjetë euro) për një mbledhje.
- Anëtarët e Kuvendit Komunal të cilët janë kryetar të komiteteve dhe anëtarë të komiteteve për Politikë dhe Finansa, nuk e marrin këtë kompensim financiar.

2. Komiteti për Politikë dhe Finansa

- Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa kompensimin financiar e kanë 150 €(njëqindëpesëdhjetë euro) në muaj,
- Anëtarët e këtij Komiteti nuk kanë të drejtë të marrin kompensim financiar si anëtarë të Kuvendit për mbledhjet e Kuvendit Komunal.

3. Kryetarët e Komiteteve

- Kryetarët e Komiteteve kompensimin do ta kenë 150 €(njëqindëpesëdhjetë euro) në muaj,
- Kryetarët e Komiteteve, të cilët janë edhe anëtarë të Kuvendit Komunal nuk kanë të drejtë në kompensimin financiar në mbledhjet e Kuvendit Komunal,
- Këtë kompensim financiar kryetarët e komiteteve do ta marrin nëse mbajnë së paku 1 mbledhje të komiteteve në muaj.

4. Anëtarët e Komiteteve

- Kompensimi financiar për anëtarët e komiteteve është 25 €(njëzetepesë euro) për 1 mbledhje,
- Ky kompensim vlen për të gjithë anëtarët e komiteteve përveç të Komitetit për Politikë dhe Financa.
- Maksimumi i mbledhjeve është tri.

II

Kompensimi financiar zbritet në këto raste:

- Të gjitha këto kompensime financiare do t'i realizojnë nëse janë prezent në mbledhje në të kundërtën nuk do të realizohen.
- Për kryetarët e komiteteve dhe për anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Finansa, të cilët janë anëtar të Kuvendit Komunal, nëse nuk marrin pjesë në mbledhje të Kuvendit Komunal do të bëhet zbritja prej 50 €(pesëdhjetë euro) për 1 mbledhje,
- Kryetarët e komiteteve të cilët nuk e mbajnë së paku 1 mbledhje në muaj do të zbriten 50 €(pesëdhjetë euro) për muajin përkatës,

III

Kompensimi financiar do të llogaritet që nga konstituimi i të njëjtave.

IV

Për zbatimin e kompensimit kujdeset Drejtorati për Financa dhe Pronë, Shërbimi për punë të Kuvendit dhe Ekzekutivit.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS

01.Nr.400-264 Data 04.03.2003

KRYETARI I KUVENDIT
Ismet Beqiri